



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS
2008

Korrik, 2009

Në vitin e parë të pavarësisë, Kosova ka shënuar progres të theksuar ekonomik. Rritja ekonomike në 2008 vlerësohet të jetë 5.4 për qind, përqindje kjo më e lartë se masatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky nivel i rritjes pritet të jetë i qëndrueshëm edhe për vitet në vijim. Edhe parametrat e tjerë makroekonomik tregojnë për lëvizje pozitive në ekonominë e Kosovës. Niveli i Investimeve të Jashtme Direkte mbetet i kënaqshëm, ndërsa çmimet mbesin nën kontroll. Sektori bankar edhe më tutje është i fuqishëm dhe në rritje. Në anën tjetër, sektori fiskal është në përmirësim të vazhdueshëm. Dhe në fund, eksportet shënuan nivelin më të lartë që nga pas lufta.

Këto trende në ekonominë e Kosovës shënohen në vitin 2008, i cili ishte ishte ndër më të vështirët për ekonominë globale në dekadat e fundit. Kriza financiare, e cila mori karakterin e një krize ekonomike globale, solli recesion të thellë në vendet e zhvilluara të botës. Vendet më pak të zhvilluara, përfshirë këtu edhe vendet në tranzicion, gjithashtu u ballaquan me vështëri të caktuara ekonomike si rezultat i krizës globale. As Kosova nuk mundi të anashkalojë në tërësi krizën, edhe pse efektet e janë shumë të vogla. Ka indikacione që tregojnë për sinjale të uljes së remitencave, importeve, kredive në sektorin privat, dhe Investimeve të Jashtme Direkte në raport me vitet paraprake. Mirëpo këto efekte janë mbajtur nën kontroll përmes shpenzimeve qeveritare, sidomos përmes shpenzimeve kapitale dhe atyre në paga të cilat kanë ndikuar veçanërisht në fuqizimin e kërkesës së brendshme.

Përkundër këtyre trendeve pozitive sfidat mbesin të shumta. Këto janë të lidhura veçanërisht me nivelin e lartë të papunësisë si dhe pozitën konkurruese të Kosovës në tregun e jashtëm. Sa i përket kësaj të fundit, bilanci tregtar i vazhdueshëm negativ tregon për urgjencën e qasjes gjithëpërfshirëse institucionale ndaj këtij problemi. Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme se ndryshimi i këtij realiteti kërkon qasje dhe reforma gjithëpërfshirëse ekonomike dhe politike në mënyrë që të ndryshohet mjedisi operues në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të pozitës konkurruese të Kosovës në tregun botëror. Si rezultat, ato aspirojnë të ndryshojnë dhe plotësojnë politikat ekzistuese ekonomike dhe të përmirësojnë funksionalitetin institucional. Kjo, në një masë të madhe, do të avanconte mjedisin operues në Kosovë.

Në këtë kontekst, MTI ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm institucional për avancimin e pozitës së sektorit eksportues të Kosovës në tregun e jashtëm. MTI ka finalizuar dokumentin e ri të Politikës Tregtare të Kosovës. Ky dokument është një vazhdimësi e dokumentit të vitit 2004 dhe disa

dokumenteve të mëparshme qeveritare mbi regjimin tregtar të Kosovës. Plotësimet e paraqitura në dokument marrin në konsideratë ndryshimet politike si rrjedhojë e pavarësismit të vendit, e cila ka ndryshuar kontekstin dhe pozitën politike të Kosovës në arenën ndërkombëtare, që gjithashtu është e reflektuar edhe në pozitën ekonomike të Kosovës. Për më tepër, dizajnimi i kësaj politike është trajtuar në kontekst të procesit të integritit të Kosovës në BE. Ndryshimet në këtë dokument gjithashtu marrin në konsideratë sinjalet nga komuniteti i biznesit në Kosovë dhe nga palët tjera ekonomike të interesuara. Bazuar në këtë dokument, MTI në vitin 2009 do të fillojë me pregaditjen e Strategjisë së Promovimit të Eksportit. Të dyja këto dokumente bazë do të paraqesin një plan të detajuar të masave për ngjalljen e sektorit eksportues të Kosovës. Edhe ky raport përshruet i sektorit të jashtëm të Kosovës është një përpjekje tjetër e MTI-së për të treguar përkushtimin e saj në avancimin e sektorit të jashtëm.

Lutfi Zharku

Ministër i Tregtisë dhe Industrisë

Korrik, 2009

Përmbajtja

1. Hyrje.....	5
2. Zhvillimet në Tregtinë Ndërkombëtare.....	5
3. Zhvillimet në Ballkanin Perëndimor.....	6
4. Zhvillimet Ekonomike në Kosovë	8
4.1 Politika Tregtare e Kosovës	9
4.1.1 Marrëveshjet tregtare për liberalizim të mëtejme	10
4.1.2 Politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë e jashtme	11
4.2 Këmbimet Tregtare të Kosovës.....	13

Tabelat

Tabela 1: Eksporti dhe importi sipas procedurave statistikore.....	16
Tabela 2: Eksporti dhe importi në vitin 2008 sipas seksioneve të sistemit të harmonizuar.....	17
Tabela 3: Partnerët kryesor tregtar.....	20

Figurat

Figura 1. Bilanci tregtar i Kosovës, 2001-2008.....	15
Figura 2. Eksportet kryesore sipas kapitujve.....	18
Figura 3. Importet kryesore sipas kapitujve.....	19
Figura 4. Importi sipas kategorive të përgjithshme të produkteve.....	20
Figura 5: Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese të CEFTA-s.....	22
Figura 6. Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese të BE-së.....	23

1. Hyrje

Ky raport analizon ecuritë kryesore të shkëmbimeve tregtare të Kosovës gjatë vitit 2008. Në këtë raport janë hulumtuar një numër i caktuar dimensionesh. Fillimisht, për të gjeneruar kontekstin e diskutimit, do të diskutohen rrjedhat ekonomike ndërkombëtare, me fokus të veçantë këmbimet tregtare. Në këtë kontekst, do të analizohen edhe lëvizjet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Më pas, do të bëhet një përmbledhje e Politikës Tregtare e Kosovës, dokument ky i cili është finalizuar para pak kohësh. Në vazhdim, do të analizohen treguesit kryesorë të tregtisë së jashtme. Eksporti dhe importi i Kosovës do të analizohet në kontekst të përbërjes dhe partnerëve kryesorë tregtar. Sa i përket kësaj të fundit, analiza do të koncentrohet në grupe të caktuara vendesh, respektivisht vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të Bashkimit European (BE) si partnerët kryesor tregtar të Kosovës.

2. Zhvillimet në Tregtinë Ndërkombëtare¹

Pas disa vitesh të rritjes së shpejtë, viti 2007 dhe 2008 u shënuan me probleme të shumta për ekonominë bëtërore. Tani bota është pranë recesionit. Problemet financiare të cilat morën hov nga mesi i vitit 2007, rritja marramendëse e çmimeve të naftës dhe tendencat për politika shumë restriktive monetare në disa vende ua trasuan rrugën vështërsive ekonomike të vitit 2008. Si rezultat, prodhimi botëror shënoi rënie të ndieshme. Në nivel botëror, rënia ishte për 1.3%. Veçanërisht në vendet e zhvilluara rënia në prodhimin e përgjithshëm ishte shumë evidente. Për vendet e zhvilluara prodhimi i përgjithshëm në vitin 2008 shënoi rënie për 1.4% në raport me vitin paraprak. Në këtë grup të vendeve, rënie më të madhe shënoi Japonia prej 1.7% në raport me vitin paraprak. Edhe vendet në zhvillim si dhe ato në tranzicion nuk ishin rezistente ndaj këtyre vështërsive, edhe pse efektet nuk duken aq gjithëpërfshirëse si në rastin e vendeve të zhvilluara. Për vendet në tranzicion rritja e prodhimit të përgjithshëm në vitin 2008 ishte 6.9% ndërsa në vitin 2007 ishte 8.3%. Sa u përket vendeve në zhvillim, prej 7.1% sa ishte rritja në 2007, në vitin 2008 kjo rritje ishte 5.9%.

¹ Informatat dhe të dhënat në këtë pjesë janë të bazuara në: Kombet e Bashkuara (2009), *World Economic Situation and Prospects 2009*, [online] <http://www.unctad.org/Templates/webflyer.asp?docid=10852&intItemID=2068&lang=1&mode=downloads>; si dhe, UNCTAD (2009), *Trade and Development Report, 2008*, [online] <http://www.unctad.org/Templates/webflyer.asp?Docid=10438&intItemID=1397&lang=1&mode=downloads>.

Problemet me të cilat u ballafaqua bota në vitin 2008 u reflektuan edhe në këmbimet tregtare. Tregtia botërore në vitin 2008 shënoi rritje prej 4.4%, që tregon rënie nga vitit paraprak kur ishte 6.3% (përafërsisht gjysma e mesatares së rritjes për periudhën 2004-2007, që shënon 8.6%). Kjo ulje ishte kryesisht rezultat i zvoglimit të importeve të SHBA-ve, të cilat përbëjnë 15% të totalit të importeve botërore. Njëkohësisht, edhe eksportet e SHBA-ve shënuan rënie. Edhe eksportet e vendeve të Europës u ndikuan nga kriza e përgjithshme ekonomike, posaqërisht nga rënia e kërkesës në tregun e SHBA-së. Gjatë vitit 2008 kishte rënie të rritjes së eksportit në Europën Perëndimore prej 3.9% në 3.6%. Përafërsisht të njëjtat efekte vërehen edhe në Azi, veçanërisht në Japoni. Vendet e Afrikës dhe Amerikës Latine në fillim të vitit përfituan nga çmimet e larta për produkte dhe shërbime (sidomos ato të lidhura me bujqësi apo turizëm) për të rritur eksportet, mirëpo gjatë gjysmës së dytë të vitit trendet në çmime morën kahje të kundërt duke krijuar efekte të kundërta.

Projektimet tregojnë se kërkesa për importe në shumicën e vendeve pritet të ulet edhe më tutje, duke rritur gjasat për ulje të mëtutjeshme në tregtinë botërore.

Të shumta ishin masat që u ndërmorën gjatë vitit 2008 për të zvogluar efektet e krizës, por pa shumë efekte. Ato ishin të drejtuara kryesisht në sektorin financiar. Regullimi i sektorit financiar ishte ndër hapat e parë, pastaj, injektimi i fondeve të mëdha publike për rekapitalizimin e bankave ishte një masë tjetër e aplikuar. Si rezultat, Qeveritë e vendeve u bënë bashkëpronare të bankave në telashe dhe ofruan garancione në depozita dhe asete të tjera financiare me qëllim të rritjes së besueshmërisë në këtë sektor. Mirëpo, duket se pa masa të fuqishme makroekonomike, dhe atë të koordinuara mirë nga të gjithë aktorët e rëndësishëm në tregun botëror, recesioni i përgjithshëm botëror është i paevitueshëm.

3. Zhvillimet në Ballkanin Perëndimor^{2,3}

Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor u prekën më pak nga kriza ekonomike. Të dhënat tregojnë se rënia e aktivitetit ekonomik në këto vende nuk ishte as përfërsisht si ajo në vendet e zhvilluara. Në të vërtetë, disa vende u prekën shumë pak nga kriza. Mirëpo, ekziston një konsensus i gjerë se asnjë

² Përveç Kosovës (trendet ekonomike të së cilës do të diskutohen në vijim) vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë: Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Sërbia, Bosnja e Hercegovina dhe Kroacia.

³ Informatat dhe të dhënat në këtë pjesë janë të bazuara në: Komisioni European (2009), *The Western Balkans in Transition*, [online] http://ec.europa.eu/economy_finance/publications.

vend nuk do të jetë imun ndaj krizës. Të parat vende të rajonit të cilat u ballafaquan me efektet e krizës ishin Kroacia, Sërbia dhe Mali i Zi, në pjesën e dytë të vitit 2008. Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina nuk i vërejtën shumë efektet e krizës. Një shpjegim për këtë dukuri duket të jetë e lidhur me faktin se struktura dhe niveli i këmbimeve tregtare dhe i investimeve të vendeve të rajonit me botën është i ndryshëm. Pra vendet të cilat kanë lidhje të fuqishme tregtare dhe investuese me BE-në janë ndikuar më herët dhe ky ndikim ishte i intensitetit më të lartë. Në anën tjetër, vendet të cilat kanë më pak lidhje me BE-në dhe vendet e zhvilluara të cilat kanë qenë më tepër të prekura nga kriza, si Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina, duken të kenë qenë më rezistuese nga efektet e krizës.

Thënë në shifra, pas një rritje ekonomike impulsive në vitin 2007 (rritja mesatare e BPV-së ishte 6.3%), në vitin 2008 kjo rritje në vendet e Ballkanit Perëndimor filloi të ngadalësohej. Aktiviteti ekonomik në 2007 ishte rezultat i kërkesës së fuqishme në tregun e brendshëm si dhe i rritjes së kredisë dhe të pagave. Eksportet e rajonit në vitin 2008 shënuan rritje në mesatare prej 9%. Mirëpo, si rezultat i ngadalësimit të rritjes në 15 vendet e BE-së (vendet e eurozonës) niveli i tillë i rritjes së eksportit nga rajoni nuk është i qëndrueshëm. Nga ana e ofertës, para së gjithash shërbimet si dhe aktivitetet e ndërmjetësimit financiar, telekomunikimet, transporti, dhe tregtia, ishin kontribuesit më të mëdhenj të rritjes ekonomike në rajon. Në rastin e Kroacisë dhe të Malit të Zi, turizmi ishte një tjetër determinantë e rritjes ekonomike. Ndërsa në rastin Shqipërisë dhe Maqedonisë kontribues i rëndësishëm i rritjes ishte sektori i ndërtimtarisë. Jo vetëm për këto dy vende, mirëpo edhe për vendet e tjera të rajonit sektori i ndërtimtarisë është një ndër sektorët më dinamik ekonomik. Përveç Sërbisë, ky sektor në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përbën më tepër se gjysmën e formimit të bruto kapitalit fiks. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është prodhimi industrial, i cili ka lëvizur në të gjithë rajonin. Në këtë kontekst, prodhimi i produkteve me bazë të metaleve duket të jetë sektori industrial më i ndikuar nga kriza, në veçanti nga kërkesa e zvogëluar botërore si dhe nga rënia drastike e çmimeve.

Edhe përkundër niveleve relativisht të larta të rritjes ekonomike, norma reale e konvergencës me vendet e BE-së dallon nga vendi në vend. Mesatarisht, BPV-ja e vendeve të Ballkanit Perëndimor mbetet vetëm 20% e mesatares së 27 vendeve të BE-së.

4. Zhvillimet Ekonomike në Kosovë

Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në fusha të caktuara ekonomike gjatë vitit 2008. Rritja ekonomike në 2008 vlerësohet të jetë 5.4%, duke tejkaluar kështu mesataren e vendeve të Balkanit Perëndimor për të cilat Komisioni Evropian vlerëson rritje prej 2.6%. Për 2009 dhe 2010 rritja sipas KASH është projektuar të jetë rreth 4.1% gjegjësisht 4.8%, ndërsa pritet që rritja të tejkalojë 5.3% gjegjësisht 6.0% në vitet 2011 dhe 2012. Edhe përkundër këtyre trendeve, Kosova mbetet vendi me BPV për kokë banori më të ultën në Europë. BPV për kokë banori në Kosovë në vitin 2008 kap shifrën prej €1,850.

Sa i përket krizës globale ekonomike Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson se ekonomia Kosovare është prekur shumë pak nga këto rrjedha si rezultat i eksporteve të vogla dhe rritjes së vazhdueshme të shpenzimeve publike. Mirëpo, rreziqet sipas FMN-së mbesin. Që tani shihen sinjale të uljes së dërgesave nga jashtë (diaspora), importeve, kredive në sektorin privat, dhe Investimeve të Jashtme Direkte.⁴

Një sfidë e veçantë mbetet bilanci negativ tregtar, i cili është rritur në 2008 duke arritur shifrën prej 42.6% të BPV-së (vetëm për produkte). Edhe bilanci i rrjedhës (pas asistencës së jashtme) mbetet poroz, duke kapur shifrën prej afër 22% të BPV-së (më tepër detaje për sektorin e jashtëm në Kosovë do të ofrohen në pjesët në vijim). Ky bilanc negativ është financuar kryesisht nga asistenca e jashtme financiare si dhe dërgesave nga jashtë (diaspora). Këto të fundit edhe në vitin 2008 kanë shënuar rritje për rreth 5% (shuma e të cilave është vlerësuar në €452 milion), duke mbetur kështu një burim i rëndësishëm i të hyrave për Kosovën.

Niveli i lartë i papunësisë mbetet brengë e madhe për ekonominë e Kosovës. Numri i personave të cilët hyjnë në tregun e punës mbetet konstant, diku rreth 30,000 në vit. Tani të regjistruar si të papunë janë diku afër 350,000 persona. Norma e papunësisë vlerësohet të jetë mbi 40 përqind. Mirëpo, si rezultat i të dhënave jo kualitative për këtë segment të ekonomisë si dhe pjesëmarrjes së madhe të ekonomisë joformale në Kosovë duhet të mirren me kujdes të shtuar.

Kosova ka shënuar nivel relativisht të lartë të infacionit në vitin 2008, duke arritur në 9.4 përqind prej 4.4 përqind sa ishte në 2007. Është evidente se ky nivel i lartë i inflacionit është rrjedhojë e rritjes së çmimeve të ushqimit dhe të naftës. Se sa është efekti real i kësaj rritjeje në kërkesën efektive nuk është e

⁴ Deklarata përmbyllëse e stafit të IMF-it në Kosovë e datës 24.06.2009 [online] <http://www.imf.org/external/np/ms/2009/062409.htm>.

mundur të përcaktohet si rezultat i mungesës së të dhënave. Si do që të jetë, indikacionet janë që në vitin 2009 dhe vitet në vazhdim çmimet janë dhe do të mbesin stabile.

Për fund, sektori bankar mbetet stabil, edhe pse një qëndrueshmëri e tillë është e vështirë të mbahet si pasojë e trendeve të fundit ekonomike në botë. Në anën tjetër, buxheti i vitit 2008 si dhe buxheti i planifikuar për vitin 2009 janë tejte ekspansiv. Shpenzimet kapitale në 2008 janë dyfishuar në raport me atë të vitit 2007. Për më tepër, Kosova ka vazhduar me reformat strukturore edhe në vitin 2008. Agjencioni Kosovar i Privatizimit vazhdoi me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore pas marrjes së kompetencave nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit. Tani sfida kryesore mbetet privatizimi i ndërmarrjeve publike.

4.1 Politika Tregtare e Kosovës

Tregtia e jashtme konsiderohet si një nga mekanizmat kryesor të rritjes në Kosovë. Për këtë arsye politika tregtare mbetet një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Aspekti fundamental në politikën tregtare të Kosovës është orientimi drejt liberalizimit. Anëtarësimi në mekanizmat regjional dhe më gjerë të lehtësimit të tregtisë ndërkombëtare është një nga prioritetet e politikës ekonomike në Kosovë. Zgjerimi i tregtisë përmes liberalizimit kërkon realizimin e një numri aspektesh, si: racionalizimi dhe zëvendësimi i importeve, lehtësimi i tregtisë së jashtme, dhe promovimi i eksportit. Kjo qasje njihet si strategji e integruar e eksportit e cila i jep rëndësi të barabartë ngritjes së nivelit të konkurrencës si në tregun e jashtëm ashtu edhe në atë të brendshëm. Mirëpo, liberalizimi si i vetëm nuk mjafton të krijojë efekte gjithëpërfshirëse ekonomike. Ekzistojnë arsye të shumta për këtë: së pari, politika tregtare duhet të formulohet, implementohet, dhe të vlerësohet në atë mënyrë që do ta ketë prioritet zhvillimin e jo vetëm avancimet në sektorin e tregtisë së jashtme. Së dyti, me qëllim që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë më të lartat dhe më të qëndrueshmet, jo vetëm politika tregtare mirëpo edhe politikat e tjera të lidhura me tregtinë e jashtme duhet të kuptohen dhe të menaxhohen mirë. Në fund, tregtia e jashtme është një koncept i cili prek shumë sfera të jetës ekonomike dhe asaj sociale. Prandaj, nevojitet përmirësimi i vazhdueshëm i kualitetit të institucioneve, duke përfshirë këtu edhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve relevant në Kosovë në sistemin e tregtisë së jashtme.

Një numër i madh i dimensioneve që janë të lidhura me politikën tregtare i tejkalojnë kompetencat e MTI-së si institucion kryesor në këtë proces. Pra, për

realizimin e kësaj politike duhet të përfshihen edhe aktorë të tjerë të shumtë të jetës ekonomike Kosovare (institucione qeveritare dhe ato jashtë qeverisë). Prandaj, në raste kur në proces duhet të përfshihen aktorë të ndryshëm dokumenti propozon masa të cilat duhet ndërmarrë, ndërsa në raste kur një masë e caktuar është përgjegjësi e vetme e MTI-së atëherë kjo e fundit merr përsipër realizimin e kësaj mase. Ky dokument paraqet vizionin e Kosovës në politikën e tregtisë së jashtme. Megjithatë, ky nuk është dokument shumë i detajizuar në kuptimin e masave të cilat i propozon për avancimin e sektorit të jashtëm. Është menduar që çështjet e caktuara të cilat i thekson dokumenti të përcillen me dokumente shtesë të cilat do të detajzonin masat e propozuara.

Drejtimet e Politikës Tregtare të Kosovës janë dhënë së pari në kontekst të marrëveshjeve tregtare, dhe së dyti, në kontekst të politikave të lidhura me tregtinë e jashtme. Në fund, mënyrat për fuqizimin e institucioneve të lidhura me tregtinë e jashtme janë elaboruar. Në vijim, do të flasim për masat të cilat dokumenti i Politikave Tregtare të Kosovës parasheh në këto drejtime.

4.1.1 Marrëveshjet tregtare për liberalizim të mëtejshëm

Në kontekst të marrëveshjeve tregtare (pra të përfshirjes së mëtejshme të Kosovës në procesin e liberalizimit) janë tri aspekte të rëndësishme të cilat në njëfarë mënyre përcaktojnë edhe politikën tregtare të një vendi. Këto janë: [1] qasja në tregjet e jashtme, ku shumica e negociatave (psh. në rastin e anëtarësimit në OBT) koncentrohen në bujqësi, industri, dhe shërbime; [2] ndryshimet ligjore, institucionale dhe rregullative; dhe, [3] hapësira (horizonti) i politikëbërjes. Sa i përket aspektit të parë, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë dhe veçanërisht anëtarësimi në OBT do t'i ofronin Kosovës qasje të lehtë në tregje të huaja dhe me shpenzime më të ulëta të transaksioneve. Në anën tjetër, kjo do të nënkuptonte uljen e barrierave tarifore dhe jo-tarifore për kategori të caktuara të importeve. Implikimet e të dyja këtyre aspekteve reflektohen në rritjen ekonomike, punësim, shpërndarjen e të ardhurave, asetëve dhe resurseve, dhe në përgjithësi zhvillimin e kapitalit njerëzor. Andaj, është shumë e rëndësishme të bëhet një plan i liberalizimit të mëtutjeshëm i cili do t'u shërbente nevojave zhvillimore të Kosovës, e në të cilin po punon MTI.

Sa i përket aspektit të dytë në kontekst të marrëveshjeve tregtare, pra ndryshimeve ligjore, institucionale dhe rregullative, disa masa do të sforcohen: së pari, do të bëhet analiza e kornizës ekzistuese ligjore; më pas, do të krahasohet struktura ekzistuese ligjore me rregullativat të cilat kërkohen në kuadër të marrëveshjeve bilaterale, regionale, dhe multilaterale (OBT) dhe të

identifikohen zbrazëtirat; dhe së treti, do të hulumtohet fleksibiliteti që ofron sistemi tregtar botëror dhe ky fleksibilitet të shfrytëzohet për shtyrjen e qëllimeve zhvillimore të Kosovës.

Sa i përket horizontit të politikëbërjes, janë disa çështje që institucionet janë duke iu kushtuar kujdes. Disa nga propozimet janë si në vijim: ndërlidhja e procesit të liberalizimit të tregtisë me fleksibilitetin e Kosovës për të formuluar dhe implementuar politika zhvillimore. Në lidhje me këtë çështje diskutimet po fokusohen në implikimet makroekonomike dhe sektoriale të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Sa i përket implikimeve makroekonomike, vëmendja koncentrohet në implikimet e këtyre marrëveshjeve në të hyrat publike si dhe ndikimin e tyre në investimet e brendshme dhe ato nga jashtë.

4.1.2 Politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë e jashtme

Në vijim diskutimi do të koncentrohet në dy fusha prioritare, eksportet bujqësore (apo bujqësinë në përgjithësi) dhe eksportet industriale (apo industrinë në përgjithësi). Edhe në këtë rast, propozimet i tejkalojnë mekanizmat implementues të MTI-së, andaj edhe masat e propozuara përfshijnë edhe aktorë tjerë implementues. Duhet potencuar gjithashtu se masat e propozuara mund të ndahen gjithashtu edhe sipas horizontit kohor të ndikimit. Pra, diskutimi sektoral mund të trajtohet edhe në afat të shkurtë, të mesëm, dhe të gjatë.

Me qëllim të adresimit të eksporteve të sektorit të bujqësisë, janë çështjet në vijim që duhet adresuar: kufizimet e lidhura me ofertën; diversifikimi dhe proceset e shtimit të vlerës; dhe qasja në tregje dhe participimi. Sa i përket kufizimeve të lidhura me ofertën, po punohet në përpilimin e një programi të integruar të masave të cilat targetojnë kufizimet në ofertë. Qëllimet e këtij programi do të jenë krijimi i nxitjeve/insentivave të cilat do të inkurajonin investimet në sektorin e bujqësisë, pastaj rritjen e produktivitetit dhe eksporteve, si dhe rritjen e konkureshmërisë në raport me eksportet e vendeve të rajonit. Në rastin e dytë (apo, diversifikimi dhe proceset e shtimit të vlerës) MTI do t'i qaset kësaj problematike përmes inicimit të programeve (së bashku me organizatat e komunitetit të biznesit) për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për prodhuesit dhe krijimin e një të ashtuquajtur 'fondi të diversifikimit' së bashku me partnerët zhvillimorë (pra, donatorët). Në fund, qasja në tregje dhe participimi është i lidhur ngushtë me kualitetin e produkteve dhe standardet shëndetësore dhe ato të ambientit. Në këtë kontekst, po hulumtohen mënyrat për pjesëmarrje të kompanive vendore në hallkat/zingjirin global të vlerës duke synuar kështu

qasjen në tregjet e vendeve të zhvilluara dhe ekonomive të rajonit. Në bashkëpunim me asociacionet e biznesit, MTI do të krijojë programe të ndërtimit të kapaciteteve për asistencë në zbatimin e standardeve në tregti. Për më tepër, MTI do të krijojë zyra të informacioneve të cilat do të ofrojnë informata mbi kërkesat për përfshirje në hallkat/zingjirët global të vlerës me qëllim të promovimit të shfrytëzimit të mundësive në tregjet dinamike.

Janë tri masa të ndërlidhura të cilët po analizohen me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve prodhuese në sektorët industrial: ngritja e konkureshmërisë së firmave prodhuese, ndihmesa në rritjen e madhësisë së firmave, dhe lehtësimi i qasjes së ndërmarrjeve në faktorë të prodhimit me qëllim të rritjes dhe ngritjes së kapaciteteve investuese. Rritjen e konkureshmërisë së firmës duhet ta shohim nga prizmi i nivelit të konkureshmësisë së ekonomisë në tërësi dhe nga niveli i konkureshmësisë së vet firmës. Sa i përket të parës, aktivitetet po ndërmirren në dy drejtime: së pari, përmirësimi i infrastrukturës bazike prodhuese me qëllim të krijimit të kushteve për prodhim të qëndrueshëm; së dyti, të inkurajohet ngritja e infrastrukturës ndër-kufitare. Në anën tjetër, sa i përket konkureshmërisë së vet firmës ato duhet ngritur produktivitetin e fuqisë punëtore përmes trajnimeve në vendin e punës dhe trajnimeve të tjera profesionale si dhe të këmbimit të përvojave më të mira në procesin e prodhimit. Për më tepër, duhet ndërtuar kapacitetet teknologjike të vet firmës me qëllim që kjo e fundit të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat dhe nevojat e sistemit të tanishëm tregtar global.

Një tjetër dimension i diskutuar në kuadër të ngritjes së kapaciteteve eksportuese të sektorit industrial është i lidhur edhe me rritjen e madhësisë së firmave në Kosovë. Realizimi i kësaj po mundësohet përmes inkurajimit të Investimeve të Jashtme Direkte si dhe përmes identifikimit dhe inkurajimit të ndërmarrësve Kosovar që të mobilizojnë resurse dhe të inicojnë biznese të mëdha.

Qasja në burime të jashtme të financimit është një tjetër dimension i rëndësishëm në kontekst të eksportit industrial. Fokusimi po bëhet në dy aspekte: së pari, zhillimi dhe përkrahja e organizmave kreditues të cilët janë më të adaptueshëm ndaj nevojave të NVM-ve; dhe, së dyti, krijimi i zyrave informative të cilat do të ulnin shpenzimet dhe do të ngushtonin asimetrinë informative në mes të institucioneve financiare dhe firmave aplikuese. Gjithashtu, krijimit të një kornizë të bashkëpunimit në mes të sektorit financiar dhe sektorit privat po i kushtohet kujdes.


Për fund, duhet potencuar se të gjitha masat që u propozuan më lart janë në masë të madhe të lidhura me performansën e institucioneve, dhe atë jo vetëm të MTI-së mirëpo edhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në politikën tregtare. MTI ka identifikuar dimensionet në vijim të cilat duhet targetuar: së pari, MTI është e vetëdijshme për nevojën imediate për përmirësimin e kapaciteteve institucionale (humane dhe teknike). Së dyti, ky përforsim i institucioneve në aspektin human dhe teknik gjithashtu do të forcojë edhe koordinimin në mes të MTI-së dhe të aktorëve të tjerë në sistem. Në fund, do të avancohen burimet e dijes, pra institucionet që ofrojnë informata dhe të dhëna, dhe puna e tyre do të jetë e koordinuar dhe konsistente në mënyrë që të ketë koherencë në sistem.

4.2 Këmbimet Tregtare të Kosovës⁵

Ekonomia Kosovare ka pasur oscilime të theksuara në rritje ekonomike në periudhën e pas-luftës. Në vitin e parë të pas-luftës rritja ishte shumë e madhe mirëpo prej një baze shumë të ulët. Më vonë ky trend i rritjes ishte e pamundur të mbahej dhe Kosova në vitet në vijim shënoi një rritje relativisht modeste. Edhe pse në këtë periudhë janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makroekonomik në konsolidimin e ekonomisë Kosovare pas stagnimit shumëvjeçar të viteve nëntëdhjeta, shumë indikatorë tregojnë një pasqyrë që thekson sfida të shumta të ekonomisë nacionale. Një ndër ta është edhe bilanci tregtar i Kosovës (shih Figurën në vijim), diferenca e të cilit para së gjithash tregon nivelin e ulët të konkurrueshmërisë së produkteve Kosovare në tregun e jashtëm. Kosova është ekonomi e varur në masë të madhe nga importet (importet përbëjnë afër 50% të BPV-së) dhe trendet tregojnë se në afat të shkurtë vështirë është të pritet ndonjë ndryshim i madh.

⁵ Të dhënat në këtë pjesë janë të bazuara në publikimin e Entit të Statistikave të Kosovës (2009), *Tregtia e Jashtme 2008*, Prishtinë: K.G.T.

Figura 1: Bilanci tregtar i Kosovës (2001-2008; në mil. €)



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Eksportet në periudhën e pasluftës kanë shënuar rritje impresive (mbi 60% mesatarisht në vit për periudhën 2001-2008) mirëpo nga një nivel shumë i ulët fillestar i eksportit. Në anën tjetër, për të njëjtën periudhë, edhe importet kanë shënuar rritje signifikante prej 15% mesatarisht në vit. Kjo rritje e madhe e importeve ka pamundësuar mbulimin më të madh të importeve nga eksportet. Në vitin 2008 importet arrijnë shifrën prej afër 2 miliardë Euro ndërsa eksporti është përafërsisht dhjetë herë më i ultë. Një pasqyrë më premtuese do të shfaqej po që se mirret në konsideratë edhe i ashtuquajturit eksport virtuel – që përfshin konsumin e ndërkombëtarëve në Kosovë – sipas të cilit eksporti mbulon 20% të importit (në llogaritë kombëtare kjo pjesë e eksportit konsiderohet si ‘eksport në shërbime’).

Më pak se gjysma e eksportit (44.8%) në vitin 2008 është eksport i rregullt, ndërsa pjesa tjetër kryesisht është eksportuar pas përpunimit të brendshëm.⁶ Mbi 4% e totalit të eksportit Kosovar e përbën rryma. Një përqindje e eksportit është destinuar për përpunim të mëtutjeshëm. Në anën tjetër, importet gati në tërësi janë të rregullta, pra rreth 95% e totalit. Sipas të dhënave në vitin 2008, në Kosovë është importuar rrymë në vlerë prej afër € 57.5 milion, apo afër 10 milion më tepër së në vitin 2007 (shih tabelën në vijm).

⁶ Duhet potencuar se edicionet paraprake të këtij raporti kanë raportuar vetëm mbi eksportet e rregullta. Për hir të konsistencës tash e tutje do të përfshihen eksportet në tërësi.

Tabela 1: Eksporti dhe importi sipas procedurave statistikore (vlera në .000€)

	2007		2008	
	Vlera	%	Vlera	%
Gjithsejt eksportet	165.112	100,0	198.463	100,0
Eksportet rregullta	96.419	58,4	88.928	44,8
Eksportet rregullta-rryma	12.532	7,6	8.238	4,2
Eksportet për përpunim të jashtëm	15.478	9,4	3.031	1,5
Eksportet pas përpunimit të brendshëm	40.684	24,6	98.267	49,5
Gjithsejt importet	1.576.186	100,0	1.928.236	100,0
Importet rregullta	1.499.074	95,1	1.829.646	94,9
Importet rregullta-rryma	47.836	3,0	57.424	3,0
Importet pas përpunimit të jashtëm	2.869	0,2	2.932	0,2
Importet për përpunim të brendshëm	26.408	1,7	38.234	2,0

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Sa i përket strukturës së eksporteve, ato kryesisht janë në formë të lëndës së parë dhe produkteve të papërfunduara. Eksportet janë të dominuara nga metali i papërpunuar (apo mbeturinat metalike) dhe produktet minerale, të cilat në periudhën 2002-2008 kanë mbuluar mesatarisht rreth 60% të totalit të eksportit. Ndërsa në vitin 2008 Kosova ka eksportuar mbi €140 milion të këtyre dy grupeve të produkteve, që përbën afër afër 75% të totalit të eksportit. Makineritë dhe pajisjet përbëjnë një komponentë në rritje të eksporteve të Kosovës sidomos në vitet pas 2005. Në vitin 2008 Kosova ka eksportuar mbi 4% të totalit produkte të kësaj kategorie. Po e njëjta përqindje është edhe për produktet bimore. Gjithashtu edhe produktet ushqimore mbulojnë një përqindje të rëndësishme të eksportit (mesatarisht mbi 10% prej 2003 deri në vitin 2008). Mbi 10 milion Euro janë eksportuar produkte ushqimore dhe pije të ndryshme nga Kosova në vitin 2008. Në këtë kontekst duhet veçuar verën e cila eksportohet në Gjermani dhe vendet e rajonit. Më tutje, lëkurat dhe produktet e ngjajshme si dhe industria e gomës kanë pjesëmarrje të rëndësishme në strukturën e eksporteve të Kosovës. Duhet thekuar se produktet e lëkurës janë të vetmet produkte të cilat kanë bilanc pozitiv tregtar, duke tejkaluar importet për 73%.

Tabela 2: Eksporti dhe importi në vitin 2008 sipas seksioneve të sistemit të harmonizuar (në .000€)

	Eksporti		Importi		Balanci	
	Vlera	%	Vlera	%	Diferenca	Eks./ Imp.
Kafshë të gjalla dhe prod. të ngajshme	1,158	0.58	85,426	4.43	-84,268	1.36
Produkte bimore	8,986	4.53	103,634	5.37	-94,648	8.67
Yndyrna	23	0.01	22,719	1.18	-22,696	0.10
Ushqime të përgaditura, pije, duhan	10,597	5.34	261,917	13.58	-251,320	4.05
Produkte minerale	18,669	9.41	378,629	19.64	-359,960	4.93
Produkte të industrisë kimike	1,773	0.89	138,783	7.20	-137,010	1.28
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	6,476	3.26	86,082	4.46	-79,606	7.52
Lëkurë dhe artikuj nga lëkura	4,861	2.45	2,801	0.15	2,060	173.55
Druri dhe artikuj druri	1,730	0.87	41,685	2.16	-39,955	4.15
Letër dhe artikuj prej letre	1,099	0.55	39,012	2.02	-37,913	2.82
Tekstil dhe artikuj tekstili	2,536	1.28	63,982	3.32	-61,446	3.96
Këpucë	102	0.05	18,275	0.95	-18,173	0.56
Arti. prej guri,allqie,prod.qer. dhe qelqi	1,460	0.74	67,195	3.48	-65,735	2.17
Perla,gurë të çmuar metale të çmuara	91	0.05	1,008	0.05	-917	9.03
Metale bazë dhe artikuj të tyre	124,774	62.87	179,625	9.32	-54,851	69.46
Makineri,paisje mek. dhe elektronike	8,789	4.43	239,927	12.44	-231,138	3.66
Mjetet e transportit	2,342	1.18	131,148	6.80	-128,806	1.79
Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore	652	0.33	21,410	1.11	-20,758	3.05
Armët dhe municionet	0	0.00	368	0.02	-368	0.00
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	2,345	1.18	44,512	2.31	-42,167	5.27
Veprat e artit	0	-	100	0.01	-100	0.00
	198,463	100.00	1,928,236	100.00	-1,729,773	10.29


Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Figura në vijim tregon strukturën e eksporteve të vitit 2008 të zbërthyer edhe në më tepër detaje. Siç shihet pjesa më e madhe e eksportit kosovar është me bazë minerale. Mbi 50% e eksportit kosovar është në formë të hekurit dhe çelikut, të papërpunuar, apo mbi €100 milion. Më pas bakri dhe alumini janë dy komponentë tjerë të rëndësishëm në eksportet e Kosovës me mbi €11 milion të eksportuara. Gjithashtu, lëndët djegëse përbëjnë një tjetër produkt të

rëndësishëm eksporti. Me një pjesëmarrje signifikante në eksportet e Kosovës janë edhe paisjet elektrike, pijet, produktet e gomës, lëkurat e papërpunuara, e të tjerë produkte.

Në anën tjetër, në vitet e pasluftës, të mirat e konsumit kanë gjeneruar pjesën më të madhe të importeve të Kosovës. Pjesëmarrja e produkteve ushqimore ka dominuar importet nga mbarimi i 1999, duke mbuluar mesatarisht 21% të totalit (për periudhën 2002-2008). Kjo pjesëmarrje ka qenë edhe më e madhe në vitet e para të pasluftës, gjë që është e kuptueshme duke pasur parasysh nevojat e popullatës pas lufte dhe kolapsin ekonomik të Kosovës. Viti 2004 shënon ndryshim substancial në strukturën e importeve me ç'rast kategoritë e tjera të të mirave zëvendësojnë produktet ushqimore si më të kërkuarat nga tregu i importit. Vendin e tyre e zënë produktet minerale si dhe makineritë dhe paisjet. Në stukturën e importeve të Kosovës viteve të fundit pjesëmarrje signifikante kanë edhe mjetet transportuese, produktet pjesë e industrisë së gomës si dhe ato kimike. Ky ndryshim është indikativ për një tendencë të re të ngjalljes dhe forcimit të sektorit prodhues në Kosovë.

Figura 2: Eksportet më të mëdha sipas kapitujve (2008 në 000€)




Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Në vitin 2008, produktet ushqimore ende mbesin një nga komponentat kryesore në strukturën e importeve të Kosovës, me afër 8% të totalit. Tani,

pjesëmarrjen më të madhe në importet e Kosovës e zënë nafta dhe derivatet e saj, me pjesëmarrje prej afër 18% të totalit apo afër €350 milion në vlerë. Shumë inkurajues është fakti së vendin e dytë në strukturën e importeve të Kosovës e zënë makineritë dhe paisjet me rreth € 240 milion të importuara, apo 12.5% e importeve. Të tjera grupe produktesh të rëndësishme në strukturën e importit janë edhe: hekuri dhe çeliku si dhe mjetet e transportit, pastaj produktet nga plastika dhe goma, duhani, pijet, druri, keramika, e të tjerë.


Figura 3: Importet kryesore sipas kapitujve (2008, në 000€)



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Në këtë kontekst, duhet diskutuar edhe figurën në vijim, e cila prezenton importet sipas kategorive të përgjithshme të produkteve, pra sipas produkteve konsumuese, të ndërmjeme, dhe të mirat kapitale. Siç shihet nga grafikoni trendet janë pozitive nëse analizojmë situatën prej vitit 2005 deri në 2008. Importet e të mirave kapitale dhe produkteve për procesim të mëtejme janë duke zëvendësuar produktet e konsumit. Prej 2005 deri në 2008 importi i të mirave për konsum ka pësuar rënie prej 4.9%, në favor të të mirave kapitale dhe ato të ndërmjeme. Ky ndryshim kualitativ është indikativ për një trend të ri në ekonominë Kosovare që synon rimëkëmbjen dhe fuqizimin e sektorit prodhues në Kosovë. Gjithashtu ky është një indikacion se ekziston një proces i zëvendësimit të importeve. Në të vërtetë tregon një tendencë të ngritjes së konkureshmërisë së ekonomisë së Kosovës në tregun e jashtëm.

Figura 4: Importi sipas kategorive të gjera të produkteve, % e totalit



Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës (2009)

Struktura e eksportit dhe e importit sipas partnerëve tregtar është dhënë në Tabelën 3. BE-ja dhe vendet anëtare të CEFTA-s janë partnerët kryesor të Kosovës në tregtinë e jashtme. Mbi $\frac{3}{4}$ e importeve dhe eksporteve janë realizuar me këto grupe shtetesh gjatë periudhës 2003 – 2008 (situata është e njëjtë edhe në vitet para 2003). Sa i përket tregtisë me vendet e CEFTAs, është evidente se lidhjet me ish vendet Jugosllave ende janë të forta. Në periudhën e lartpërmendur, Maqedonia dhe Sërbia janë partnerët kryesor regional duke mbuluar kështu rreth $\frac{1}{3}$ e eksporteve respektivisht importeve të Kosovës. Vendet tjera kanë pjesëmarrje më të ultë; rëndësia e Shqipërisë si partner tregtar është në rritje sidomos pas ratifikimit dhe funksionalizimit të MTL-së të vitit 2004. Të tjerat vende të rajonit nuk kanë pjesëmarrje signifikante në këmbimet tregtare me Kosovën.

Tabela 3: Partnerët kryesor tregtar (në %)

		2003	2004	2005	2006	2007	2008
BE	<i>Eksporti</i>	41.7	29.3	38.8	38.2	42.6	47.8
	<i>Importi</i>	28.4	39.9	38.0	34.8	35.2	36.2
CEFTA	<i>Eksporti</i>	51.3	41.6	53.0	46.7	41.3	30.9
	<i>Importi</i>	45.6	34.7	38.0	41.1	36.7	37.5
Të tjerë	<i>Eksporti</i>	7.0	29.1	8.2	15.1	16.1	21.3
	<i>Importi</i>	26.0	25.4	24.0	24.1	28.1	26.2

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Sa i përket këmbimit me vendet e BE-së, Italia prin si vendi më atraktiv për eksport duke mbuluar afër 30% të eksporteve të Kosovës në BE, mesatarisht nga 2003 deri në maj të 2008. Pas Italisë, Gjermania dhe Greqia renditen si e dyta dhe e treta. Po të njëjtat vende janë gjithashtu edhe burimi kryesor i importeve (po flasim për të njëjtën periudhë si më lartë), mirëpo me një renditje ndryshe; Gjermania është vendi i BE-së nga i cili importohet më së tepërmi, e pasuar nga Greqia dhe Italia. Në kategorinë e vendeve të tjera (shih Tabelën 3), edhe pse me pjesëmarrje më të vogël, partnerët kryesor janë Turqia dhe Zvicra sa u përket eksporteve, ndërsa Kina dhe Turqia prej nga importohet.

Edhe në vitin 2008 struktura e këmbimeve të jashtme nuk ndryshon substancialisht, së paku sa i përket importit (shih figurat dhe tabelat në vijim). Edhe më tutje importuesi kryesor është Maqedonia me 18% të totalit të importeve në Kosovë. Nafta dhe derivatet e naftës kanë qenë produkti kryesor i cili është importuar nga Maqedonia. Për më tepër, nga Maqedonia janë importuar edhe produkte çeliku dhe hekuri si dhe produkte ushqimore dhe pije. Pas Maqedonisë, vijnë shtetet si Serbia dhe Gjermania me mbi 10% të totalit të importeve (10.8% Serbia dhe 10.2% Gjermania, respektivisht). Produktet kryesore që janë importuar nga Serbia janë ato për ndërtimtarë. Të tjera produkte të importuara nga Serbia gjatë vitit 2008 janë edhe produktet ushqimore, pijet jo-alkoolike, plehërat, letra, e të tjera. Më pas Turqia dhe Kina mbulojnë mbi 13% të importeve Kosovare (6.7% Turqia dhe 6.3% Kina, respektivisht). Vendet e tjera të rëndësishme në strukturën e importit janë gjithashtu edhe Greqia, Sllovenia, Shqipëria, dhe vende të tjera. Nga Greqia në vitin 2008 është importuar kryesisht naftë dhe derivate të naftës, fruta, alumin plehëra, ndërsa nga Shqipëria është importuar produkte hekuri dhe çeliku, derivate të naftës, mobilje dhe është këmbyer rrymë elektrike. Edhe Italia ka përqindje relativisht të lartë në importin e Kosovës me 4%. Nga Italia është importuar material ndërtimor, struktura me bazë hekuri, automjete për transport, paisje elektrike, dhe të tjera produkte.

€)


	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	1,420	5.1	48,077	5.6	-46,657
2003	1,798	5	8,996	0.9	-7,198
2004	1,793	3.2	20,237	1.9	-18,444
2005	5,784	10.3	18,093	1.6	-12,309
2006	12,645	11.4	23,108	1.8	-10,463
2007	20,799	12.6	35,262	2.2	-14,463
2008	21,113	10.6	59,632	3.1	-38,519

Figure 5: Tregjet kryesore ek




€

	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	3,396	12,3	146,205	17,1	-142,809
2003	6,945	19,5	141,735	14,6	-134,790
2004	9,641	17,0	149,218	14,0	-139,577
2005	10,828	19,2	220,148	19,0	-209,320
2006	9,734	8,8	257,754	19,7	-248,020
2007	17,384	10,5	237,895	15,1	-220,511
2008	20,046	10,1	346,536	18,0	-326,490



€


	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	4,745	17.2	193,840	22.7	-189,095
2003	6,754	19.0	156,410	16.1	-149,656
2004	10,060	17.8	161,281	15.2	-151,221
2005	8,158	14.5	152,257	13.2	-144,099
2006	20,910	18.9	191,053	14.6	-170,143
2007	19,280	11.7	222,534	14.1	-203,254
2008	9,893	5.0	208,951	10.8	-199,058




: Enti i statistikave të Kosovës (2009)

	€)		
	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	199	0.7	55,424	6,5	-55,225
2003	1,776	5.0	72,905	7,5	-71,129
2004	4,262	7.5	68,515	6,4	-64,253
2005	5,522	9.8	44,027	3,8	-38,505
2006	3,914	3.5	37,614	2,9	-33,700
2007	8,400	5.1	63,737	4,0	-55,337
2008	10,851	5.5	81,403	4,2	-70,552

Greqia (000 % e totalit




	€)		
	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	7,525	27.3	25,818	3,0	-18,293
2003	6,245	17.5	35,625	3,7	-29,380
2004	5,536	9.8	44,525	4,2	-38,989
2005	5,668	10.1	49,555	4,3	-43,887
2006	12,654	11.4	52,461	4,0	-39,807
2007	9,672	5.9	57,678	3,7	-48,006
2008	25,485	12.8	74,385	3,9	-48,900



	€)		
	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci
2002	2,486	9.0	33,207	3.9	-30,721
2003	3,793	10.6	54,123	5.6	-50,330
2004	3,262	5.8	78,247	7.4	-74,985
2005	5,965	10.6	123,763	10.7	-117,798
2006	3,952	3.6	122,652	9.4	-118,700
2007	16,190	9.8	155,031	13.8	-138,841
2008	7,205	3.6	196,627	10.2	-189,422

Italia (000



: Enti i statistikave të Kosovës (2009)

Mirëpo, viti 2008 ka shënuar një ndryshim signifikant në kontekst të destinimeve të eksportit Kosovar. Në këtë vit, Belgjika dhe India janë bërë dy destinacionet kryesor të eksportit, dhe kjo si rezultat i aktivitetit të kompanive prodhuese të metalit bazë (hekurit dhe nikelit). Belgjika dhe India në 2008 kanë absorbuar rreth 25% të eksportit Kosovar. Por, siç duket ky trend nuk do të mund të qëndrojë pasi që ka indikacione se këto kompani janë prekur nga kriza globale financiare. Të dhënat tregojnë se Kosova në janar të vitit 2009 ka eksportuar € 1.3 milion në Indi, ndërsa në Shkurt eksportet në këtë vend janë zero. Në të dy muajt, eksportet në Belgjike janë zero. Në 2008, në dy muajt e parë të vitit Kosova ka eksportuar në këto dy vende € 9.6 milion.

Të tjera destinacione eksportuese të prodhuesve Kosovarë në 2008 janë edhe Italia me 12.8%, Shqipëria me 10.6%, dhe Maqedonia me 10.1%. Në të trija këto vende kryesisht janë eksportuar produkte me bazë metali, pastaj lëkura të papërpunuara, produkte bujqësore, paisje elektrike, pije, dhe produkte të tjera. Dy destinacione të tjera të rëndësishme eksportuese janë edhe Greqia me 5.5% të totalit të eksporteve dhe Serbia me 5.0%. Produktet kryesore të eskportuara në Sërbi janë gypat ndërsa në Greqi janë produktet me bazë metali dhe produktet tjera minerale.

Raporti vjetor mbi tregtinë e jashtme të Kosovës është pregaditur nga Departamenti i Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. MTI falënderon z. Petrit Gashi për ekspertizën e ofruar gjatë përpilimit të këtij raporti.

Në këtë raport, burim i të dhënave për sektorin e jashtëm të Kosovës është Enti i Statistikave të Kosovës. Të dhënat e prezentuara në këtë raport përfshijnë totalin e eksportit dhe të importit. Të gjitha përpjekjet janë bërë për të siguruar saktësinë e të dhënave. Mirëpo, këto të dhëna rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe çdo përmirësim eventual do të prezentohet në raportet e ardhshme.

Ju lutem, pyetjet dhe komentet i drejtoni në:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Departamenti i Tregtisë
Rr. Muharrem Fejza pn.
Lagja e Spitalit
10000 Prishtinë
Kosovë

Tel. +381 (0) 38 200 36 519
Fax. + 381 (0) 38 212 807
<http://www.mti-ks.org/>